



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORË
SENATI AKADEMIK

Tafame kano

E Morillo
M. Morillo

Nr. 2174/6. Prot.

Vlorë më, 01.12.2023

VENDIM
Nr. 60, datë 21.11.2023

PËR
MOS MIRATIMIN E RIORGANIZIMIT NË MASËN 20% TË PROGRAMIT TË
STUDIMIT MASTER I SHKENCAVE NË "PROJEKTIM DHE MENAXHIM I
SISTEMEVE TURISTIKE DHE KULTURORE" PËR VITIN AKADEMIK 2024-2025

Në mbështetje të nenit 25 pika 7, nenit 38 pika 1, shkronja dh, nenit 75 të Ligjit nr. 80/ 2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë", nenit 19, pika 1, gërma ë, të Statutit të Universitetit "Ismael Qemali", Vlorë, si dhe referuar propozimit të Zv/Rektorit Akademik ardhur me shkresën Nr.1960/1 prot, datë 13.11.2023, propozimit të Dekanit të Fakultetit të Ekonomisë nr.1960 prot datë 25.10.2023, Senati Akademik në mbledhjen e tij të datës 21.11.2023,

VENDOSI:

1. Të mos miratojë propozimin e Departamentit të Biznesit për riorganizimin deri në 20% të programit të studimit MS në "Projektim dhe Menaxhim i Sistemeve turistike dhe Kulturore", program i dyfishtë studimi, në bashkëpunim me Universitetin "Aldo Moro", Bari, Itali
2. Departamenti i Biznesit, Fakulteti i Ekonomisë duhet të paraqesë një relacion të plotë ku të përfshijë dhe dakordësinë e ndryshimeve me Universitetin "Aldo Moro", Bari, Itali, sipas Marrëveshjes Specifike, miratuar me Vendim Senati nr.30, prot datë 13.06.2023.
3. Ngarkohet për zbatimin e këtij vendimi, Departamenti i Biznesit dhe Zëvendësrektor i Akademik

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë

KRYETARI I SENATIT AKADEMIK

Prof. Dr. Roland ZISI

